

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent

29 Mars 2022

Të nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

**Anketa vjetore në mbarë Drejtorinë është hapur tani!** Anketa në të gjithë Drejtorinë është një nga mjetet më të mira që kemi për të mbledhur komentet tuaja dhe për të vlerësuar këndvështrimin tuaj mbi tema të shumta që ndikojnë në përvojën arsimore për studentët. Përgjigjet tuaja, së bashku me përgjigjet nga sondazhet tona të studentëve dhe personelit të shkollës, na ndihmojnë të masim progresin drejt [Qëllimeve dhe Objektivave të Bordit të Arsimit](#) dhe të përmirësojmë shkollat dhe shërbimet tona duke informuar planet vjetore të shkollës dhe prioritetet e financimit, duke sqaruar burimet e komunitetit që nxënësit dhe familjet kanë nevojë, dhe më shumë.

Këtë vit, prindërit dhe kujdestarët kanë mundësinë të plotësojnë anketën 10-minutëshe të prindërve/kujdestarëve me postë ose në internet. Anketimi në letër duhet të mbërrin në adresën e shtëpisë që është në dosje në shkollën e fëmijës suaj brenda dy javëve të ardhshme. Nëse vendosni të plotësoni anketën në letër, thjesht vendoseni anketën e përfunduar në zarfin e përfshirë me parapagesë dhe na e dërgoni me postë - nuk nevojitet vulë! Nëse preferoni ta plotësoni anketën në internet, mund ta përdorni [këtu](#). Do t'ju duhet ID / numri i identitetit të studentit tuaj, i cili mund të gjendet në dëftesën e notave dhe është gjithashtu i njëjtë me numrin tuaj të drekës. Për të treguar vlerësimin tonë, kushdo që përfundon anketën në internet do të përfshihet automatikisht në një llotari javore për mundësinë për të fituar një kartë dhuratë elektronike prej 25 dollarësh.

**Periodha e Anketës në të gjithë Drejtorinë mbyllet më 10 Qershor 2022.** Pavarësisht se si vendosni të përfundoni anketën, përgjigjet tuaja do të mbeten plotësisht konfidenciale. Nëse keni probleme për t'u identifikuar ose keni pyetje në lidhje me anketën, dërgoni email ekipit të sondazhit në : [schoolsurveys@philasd.org](mailto:schoolsurveys@philasd.org). Për më shumë informacion rreth Anketës në të gjithë Drejtorinë, duke përfshirë rezultatet nga vitet e mëparshme, vizitoni [www.philasd.org/DWS](http://www.philasd.org/DWS). Ju inkurajoj të përfitonit nga kjo mundësi për të lejuar që zëri juaj të dëgjohet dhe t'ju kujtoj se aktualisht ka sondazhe të tjera – duke përfshirë [Anketimin për Buxhetin 2022](#) dhe [Anketa në lidhje me Propozimin e Programit të Orarit të Shkollës 2022-2023](#) – që kërkojnë kontributin dhe komentet tuaja.

Faleminderit që jeni pjesë e progresit!

Sinqerisht,

A handwritten signature in black ink that reads "William R. Hite Jr." with a stylized flourish at the end.

William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias